

SOME SYNTAX FEATURES IN MITRUSH KUTELI'S PROSE DISA VEÇORI SINTAKSORE NË PROZËN E MITRUSH KUTELIT

Berton SULEJMANI¹

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

^{*} Corresponding author e-mail: berton.sulejmani@unite.edu.mk

Përmbledhje

Dhimitër Pasko, i njohur me pseudonimin Mitrush Kuteli, është një shkrimtar i gjithanshëm në letërsinë shqipe. Dihet se shkrimtarët e mëdhenj janë edhe lëvrues të mëdhenj të gjuhës. Ata luajnë edhe një rol të rëndësishëm në jetën kulturore të një kombi, njëkohësisht bëhen edhe përhapës të vlerave e dukurive të ndryshme gjuhësore. Por, rëndësia e veprës letrare të Kutelit, në fushën e vlerave të letërsisë shqipe, lidhet me tregimet e novelat, me të cilat ai hap një kapitull të veçantë të prozës shqipe. Hulumtimin tim, përkatësisht nxjerrjen në pah të disa dukurive sintaksore, sipas vështrimit tim, ka qenë proza e tij. Veçoritë sintaksore në të cilat do të përqendrohem më shumë do të jenë: kongruenca e kryegjymtyrëve dhe funksioni sintaksor i lidhëzës **ndërsa** në prozën e Mitrush Kutelit.

Fjalët kyçe: Veçori sintaksore, fjali kohore, kallëzues, kryefjalë, kongruencë, marrëdhënie përfaqësore-kundërshtore.

1. Proza e Mitrush Kutelit, veç tjerash, lidhet me tregimet e novelat, me të cilat ai hap një kapitull të veçantë të prozës shqipe, që do të sjellë lëndën më të çmueshme, në të cilën do të mbështeten mendimet mbi vlerën e lartë artistike dhe mbi rëndësinë historike dhe kulturore të thesarit shpirtëror të popullit shqiptar. Nga përrallat, tregimet e moçme shqiptare, novelat e kështu me radhë, të cilat, i ka përfshirë në veprat e tij „**Ago Jakupi dhe rrëfime të tjera**”¹ dhe „**Tregime të moçme shqiptare**”² që i kemi studiuar dhe njohur nga to kemi nxjerrë shembuj të kongruencës së kryegjymtyrëve e të funksionit sintaksor të lidhëzës **ndërsa** dhe të disa lidhëzave e lokucioneve kohore karakteristike për veprën e autorit në fjalë.

Jemi përqendruar më shumë në rastet për të cilat ende nuk kemi normë sintaksore të kodifikuara, pra ende zbatohen dy lloje të kongruencës, si: kur kryefjala e fjalisë është e shprehur me një emër përmbledhës të tipit gjindja djemuria, çupëria, bota, shpësëria etj; kur kryefjala e fjalisë është e shprehur me një togfjalësh emër në emërore + parafjala me + emër në kallëzore etj. Në veçanti kemi trajtuar edhe funksionet sintaksore të lidhëzës **ndërsa**, gjithnjë duke u mbështetur në shembujt e prozës së Kutelit.

¹ Botuar nga Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Reparti - Prishtinë, Rilindja, 1968.

² Botuar nga Shtëpia Botuese „Mitrush Kuteli”, Tiranë, 2004.

1.1. Kallëzuesi i përshtatet kryefjalës në numër, në gjini, në vetë dhe në rasë (në rasë kryefjalës i përshtatet vetëm pjesa emërore e kallëzuesit emëror). Ndërmjet kryegjymtyrëve të fjalisë mund të kemi *kongruencë sipas formës* (që ndryshe quhet edhe *gramatikore*) që ka edhe përdorim më të gjerë në gjuhë. Por, në raste më të kufizuara, në gjuhë zbatohet edhe *kongruenca sipas kuptimit*. Kongruenca ose përshtatja e kryegjymtyrëve të fjalisë në gjuhën shqipe thuajse është e përcaktuar. Megjithatë, ka edhe disa raste kur kallëzuesi përdoret edhe në numrin njëjës, edhe në numrin shumës dhe që kujtoj se duhet të bëhet një zgjidhje (në rrafshin e sintaksave kodifikuese). Shkojmë me radhë:

1.2. Shembuj ku kallëzuesi i përshtatet kryefjalëve homogjene. Në këto raste kallëzuesi është në numrin shumës, pra kemi kongruencë sipas formës:

Vali-pashaj Mytesafir-beu dhe kajmekan-efendiu **bënin** shtrëngesë të madhe për punë të abetares shqipe. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 27)

Lulishtja, rrugët, oborret, çatitë **zbardhnin** sikur të ishin shtruar me flokë dëbore. („Tregime të moçme shqiptare“³, f. 11)

Gjergj Elez Alija dhe motra e tij pa emër **janë simbole** të ndritur trimërie dhe bujarie, pasqyra e vërtetë e shpirtit të papërkulur shqiptar. („TMSH”, f. 12)

Vasha e trimi **iu afruan** kuçedrës. („TMSH”, f. 41)

Mëma edhe të njëmbëdhjetë **u bindën**... („TMSH”, f. 42) etj.

Gjahu i mirë **dhe moti** i ëmbël **e mbajtnë** gjer vonë, kur perëndon dielli. („Tregime të moçme shqiptare“⁴, f. 206).

1.2.1. Kryefjala homogjene, ndërsa kallëzuesi në njëjës, (përshtatja e kryegjymtyrëve sipas afrisë – kallëzuesi i përshtatet elementit që ka afër). Veç kongruencës sipas formës, sipas kuptimit, dallohet edhe kongruenca sipas afrisë. Në fjalitë e mëposhtme kallëzuesin e kemi në njëjës, edhe pse kryefjala është një togfjalësh. Nuk i përshtatet si te shembujt e mësipërm (shih 1.2.).

Aty ku një çast më parë **gjëmonte kënga e vallja**, s'ndjehet më zë njeriu e hingëllimë kali

Në përgjithësi mund të pohohet se edhe në këto raste prirja është që kallëzuesi të vihet në numrin shumës, pra të përshtatet sipas formës me vargun e kryefjalëve homogjene: ...**gjëmonin kënga e vallja**...

1.3. Në veprën e M. Kutelit, kur kryefjala e fjalisë është e shprehur me emër *përmbledhës*, në shumicën e rasteve, kallëzuesin e hasim të përdorur në njëjës, por edhe në shumë pak raste edhe në shumës. Siç dihet, emrat përmbledhës me trajtën e numrit njëjës emërtojnë një tërësi njerëzish, kafshësh ose sendesh të një fare. Pra, ata kanë trajtën e njëjësit, por kuptimin e shumësit. Për të pasur kongruencë gramatikore, kallëzuesi duhet të përdoret në njëjës e jo në shumës. Ja disa shembuj nga veprat e studiuara:

Atë motnë e zisë, kur **bota hante** koçanë misri, të bluar, të përzjerë me urof, ti më ke mëkuar si zog. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 104)

Bota se ç`ta ka zili. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 109)

Edhe **graria** e **humbi** mendjen, s`dinte ç`të bënte, sikur ky që kish ardhur të mos paskej që në krushku Risto, po vetë Fejzo Griva, që kish ardhur për të xhveshur fshatin. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 111)

Qebaxhinj jemi, këtë e di tërë bota nuk e fshehim. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 111)

Tërë bota e **loliste** Lolin, po edhe Loli, në punë të tij, e **loliste tërë botën**. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 114)

³ Më poshtë vetëm „TMSH”.

⁴ Më poshtë vetëm „TMSH”.

Bota që kish dëgjuar, **kish thënë** se kush e di ç`tmerr i madh kish ndodhur... („Ago Jakupi dhe ...”, f. 114)

I ranë sa i ranë fyellit, gjersa **bota** u mërzi e s`ua vari më. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 133)

Po jo brenda në fshat, se **fshati** pinte ujë pusi. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 138)

Bota thotë: “Kur bën të qesh, Xha Dalipi duket si cap i egër”. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 165)

Fshati ja ka ditur dhëmbë e dhëmballë Ilo Mullëmadhit. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 181)

Bota e ka marrë vesh. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 185)

Shpeshërija që s`di ç`është hidhërimi as në verë e as në dimër, **bënte** zhurmë shumë. Aty pranë konakut të Beut dhe ay zot mbi çiflije e zot mbi njerës, e ndjente shpirtin të lodhur. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 201)

Djemt e fshatit me shtijza në dorë e shpata për brezi ngjiteshin në nxitim e sipër në kodrën e kishës ku **do të mblidhej pleqërija**. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 233)

E jo se këtyre ustallarëvet tanë nuk u vinte ndoresh për këngë, se qe të gjithë, e më fort ky Usta Vani, ta lëndonin zembrën, kur ja mirrni shtruar e ngadal donjë kënge nga të zamanit, po se me **djemuria** e **kishim mallë** më të valë e na buçiste më dendur. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 237)

Tani vreshtat ishin ndryshkur **shpeshërija** **kish ikur** edhe mushti kish zjerë në bute e piskonte me lezet të math majën e gjuhës. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 249)

Dhe asoherë zërat tonë dilnin përtej mureve të shtëpisë edhe **fqinjërija** **thesh**: - Ja, po këndon Çeçua i vogël. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 324)

Tmerrohet **ujqëria** kur i ndjen hapin. Më tej nis e lufton për vendin. („TMSH”, f. 84)

Ja edhe pak raste kur kallëzuesin e gjejmë në shumës:

Tërë graria bashkë me tri “sprijat” **fshinë** sytë me pëllëmbë. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 104)

Lëftonin aso kohe **njerëzija** me dyfegje të gjatë sa për të fjetur dyzet pula e **kur** s`mirrte zjarr stëralla këshoheshin me palla, e ku je ti! („Ago Jakupi dhe ...”, f. 214)

Në vogëli **ne⁵ djemuria** e fshatit **ngjiteshim** gjer atje për të mbledhur, si pas zakonit të vejtër, po leska e manushaqe për llazoret e vashave. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 228)

Një natë njëri prej tyre iu paskej fanitur në ëndërr një vashë e re, e veshur në të bardha, si **vishen graria** e Mokrës, edhe i paskej thënë... („Ago Jakupi dhe ...”, f. 229)

Njerëzija e fillojnë me raki sa këndon këndezi që t`i vejë dita mbarë, edhe e lenë afër mezit të natës, kur dalin lugetrit. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 308)

Edhe që asaj ditë **vinin njerëzia** e i vaditnin varrin me raki. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 314)

1.4. Kryefjala e shprehur me togfjalësh të tipit **emër në emërore + parafjala me + emër në kallëzore** funksion si kryefjalë dhe përshtatet me një kallëzues në numrin shumës kryesisht në gjuhën e folur, në gjuhën popullore. Kështu e gjejmë edhe në veprën e Kutelit e cila një pjesë e saj është hartuar sipas krijimtarisë popullore. Por në shumë pak raste. Në shqipen e sotme standarde gjithnjë e më tepër parapëlqehen ndërtimet me kryefjalë homogjene: emër ose përemër në emërore + lidhëzën (e, dhe, edhe) + emër ose përemër në emërore. Pra, në vend të ndërtimit Ali-beu me Islam-benë rrokën kordhatë në dorë përdoret më shumë ndërtimi: Ali-beu dhe Islam-beu rrokën kordhatë në dorë.

Mosvënia e kallëzuesit në shumës do të tregonte se në funksion të kryefjalës së fjalisë s`do të ishte Ali-beu me Islam-benë, por vetëm Ali-beu.⁶ Ç`është e vërteta te proza e Kutelit janë të rralla kryefjalët me strukturë **emër në emërore + parafjala me + emër në kallëzore**.

⁵ Në këtë fjali, përemri vetor **ne** bën që kallëzuesi të përdoret në shumës. Po të mos ishte para emrit përmbledhës djemuria, kallëzuesin do ta gjenin në njëjës.

⁶ Krahaso: Ali-beu me Islam-benë rroku kordhatë në dorë, në këtë rast togu me Islam-benë nuk është pjesë përbërëse e kryefjalës, por gjymtyrë më vete, kundrinë me parafjalë.

Te proza e Kutelit prijnë shembujt e përdorimit të kallëzuesit në njëjës. Këtë e dëshmojnë edhe shembujt e mëposhtëm:

Gjithë Krahina, me Jutbinën në krye, i këndonin trimërinë e bujarinë.

Pa kur hyri bylyku grykavet me dyfegjet krahut e me kujë të madhe sikur vinte të rrëmbejë dhënjt e çobenjvet, **ky Bendua me shokë** na hapi batërdinë me një të shtënë e dy të vrarë, sa ata që shpëtuan iknë të lebetitur

Isha i vogël, aty afër çezmes, kur erdhi i mori **Dulja** bashkë me ca njerëz me dyfegje në dorë e me koburë në brez.

Kur s'e priste njeriu, u hap dera e hyri shlllop-shlllop **Loli me Lolevicën**

1.5. Shembuj ku kryefjala e fjalisë është një emër vendi (toponim a mikotoponim), si: fshati, qyteti, krahina etj., i përdorur në mënyrë metonimike (p.sh.: “u rreshtua klasa e dytë” në vend të “nxënësit e klasës së dytë”) për të shënuar tërësinë e njerëzve që jetojnë atje, kallëzuesin në veprën të cilën e kemi studiuar e gjejmë në njëjës. P.sh.:

Tmerrohet gjithë Kralia kur i ndjen emrin. („TMSH”, f. 84)

Kur emrat e tillë përdoren si kryefjalë, kallëzuesi në gjuhën shqipe mund të vihet edhe në numrin shumës. Por, gjithnjë prijte po bëhet kongruencë sipas formës, d.m.th. kongruencë gramatikore të kryegjymtyrëve, është mirë, madje duhet të ngrihet si normë, përdorimi i kallëzuesin në njëjës.

1.6. Kryefjalë homogjene me lidhëzën e përsëritur **as..., as...** . Në këto raste veprimin e shprehur nga folja-kallëzues e kryejnë bashkërisht, por i takon veç e veç secilit nga kryerësit e veprimit:

Po të mos kishte qenë kështu, **as unë as ti** nuk do të ishim në jetë. („TMSH”, f. 50)

E sa po dhanë dorën që të dy, Bendua e Suli, na mbetnë miq me kokë që s'i çante **as topi as kumbaraja**. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 245)

2.1. Funkcionet sintaksore të lidhëzës ndërsa në gjuhën shqipe.

Lidhëza *ndërsa* në gjuhën shqipe, mund të përdoret edhe në funksionin e lidhëzës bashkërenditëse, që bashkon dy pjesë të njëjta të periudhës, edhe në funksionin e lidhëzës nënrenditëse, që bashkon një pjesë të varur me një pjesë drejtuese të periudhës. Në Fjalorin Shpjegues të Gjuhës Shqipe, për lidhëzën *ndërsa* jepen këto sqarime: 1. *Përdoret përpara një fjalie të varur që tregon një veprim, i cili kryhet njëkohësisht me veprimin e shprehur në fjalinë kryesore*; 2. *Përdoret përpara një fjalie të bashkërenditur që tregon një veprim a gjendje të kundërt me veprimin a gjendjen e shprehur në fjalinë tjetër*; 3. *Përdoret përpara një fjalie për të përjasur veprimin ose gjendjen e shprehur në fjalinë tjetër*.

2.1.1. “Ndërsa” si lidhëz bashkërenditëse.

Karakteristike për periudhën me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie përjasore-kundërshtore është se ato kanë një strukturë dygjymtyrëshe: çdo gjymtyrë mund të jetë fjali, ose tog fjalish me fjali të bashkërenditura, ose tog fjalish të varura.⁷ Fjalitë e këtyre periudhave shprehin ngjarje, veprime e situata të ndryshme të cilat e kundërshtojnë njëra-tjetrën. Karakteristikë dalluese e këtyre periudhave është se përbëhet prej dy pjesësh. Ky kushtëzim vjen nga vetë marrëdhënia kundërshtore, që nënkupton dy gjëra që kundërvihen njëra me tjetrën. Më shumë se dy gjëra nuk mund të kundërvihen. Lidhëza *ndërsa*,⁸ varësisht nga funksioni sintaksor merr pozicione (zë vende) të ndryshme në periudha.

⁷ AShSh, IGjL, Gramatika e gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2002, f. 469.

⁸ *Ndërsa* (si lidh. bashkërenditëse) është sinonimike me lidhëzat: *kurse, teksa*, ndër to më e përdorshme është e para.

Vendi i saj i zakonshëm është midis dy fjalive⁹ të një periudhe. P.sh¹⁰ .:

Nëna, dyllë e verdhë, me duart që i dridheshin, ndezi fenerin, ndërsa babai hodhi në kokë mushamanë e zezë, ia mori fenerin dhe shkoi të hapte portën.

S’di pse, e përfytyrova veten së bashku me shokun tim, hipur të dy mbi një rikshë me fener të kuq, ndërsa kinezi që na tërhiqte, na çonte përherë e më larg dhe ne donim t’i thoshim se kjo nuk ishte rruga “Zoti Princ” dhe kurrfarë rruge tjetër e Parisit, por një varrezë budistësh mirëpo s’kishim dëshirë të flisnim, ndërsa hieroglifët mbi rrasat e gurta, nën dritën e hënës, sa vente shtoheshin.

2.1.3. Mospërfshirja e lidhëzës “ndërsa” si bashkërenditëse në Gramatikën e gjuhës shqipe 2.

Në Gram.e Akad. 2 (Sintaksa) lidhëza *ndërsa* nuk është përfshirë në kuadrin e periudhave me fjali të bashkërenditura me marrëdhënie përqasore-kundërshtore. Aty thuhet se në shqipen e sotme letrare përdoren lidhëzat përqasore-kundërshtore: *po, por, mirëpo, porse, kurse*.¹¹ Arsyeja pse s’është përfshirë në GA 2 mendojmë se është kjo: moskrijimi i pështjellimeve, d.m.th. të mos krijohen situata të tilla ku s’do të kuptohej lehtë funksioni sintaksor i saj. Në shqipe, siç thamë, lidhëza *ndërsa* përdoret edhe si lidhëz bashkërenditëse me marrëdhënie përqasore-kundërshtore, por përdoret edhe në funksionin e lidhëzës nënrenditëse kohore. Ja një fjali kur bëhet e vështirë gjetja e funksionit të saj sintaksor:

Ajo nuk m’i hiqte sytë ndërsa flisja.

Ja edhe një shembull tjetër, ku funksioni i saj sintaksor bëhet edhe më i vështirë:

Si i tërbuar hodha mbulesën, ndërsa vazhdova të qëndroj shtrirë.

Mu për këto arsye, pra për të mos krijuar pështjellime, lidhëza bashkërenditëse *ndërsa*, ose nuk jepet fare nga ndonjë autor – Floqi – ose jepet si shënim nga ndonjë tjetër – Lafe.¹² Prof. Mehmet Çeliku thotë se si lidhëz bashkërenditëse, ajo mund të pranohet si normative, sepse ka një përdorim të gjerë dhe se ndërtimet me bashkërenditje përqasore, përveç lidhëzës, kanë edhe tregues të tjerë.

2.1.4. A duhet të pranohet si normative edhe funksioni bashkërenditës i saj?

Mendojmë se duhet të pranohet si normative sepse kjo lidhëz ka një përdorim të gjerë në Kosovë e Maqedoni. Ky përdorim i dendur i saj vërehet në të dy rrafshet: edhe në atë normativ edhe në atë dialektor. Ndërsa përdorimi i saj si kohore është shumë i vogël (kupto: në këto treva shqiptare). Në të folmet shqipe në Maqedoni, duke u mbështetur në monografitë dhe skicat dialektore (rreth 40 sosh) për këto të folme,¹³ vijmë në përfundim se si kohore e gjejmë vetëm në të folmen shqipe të Rekës së Epërme të Gostivarit me këtë formë: **zherteju**,¹⁴ shembulli: **Zhejteju afronin askeri shpellës, Dinka fluturoj pjetposht malit.**

Aty-këtu e gjejmë edhe në veprat letrare,¹⁵ por mendojmë se ky përdorim më shumë kushtëzohet nga: dijet që këta autorë kanë rreth lidhëzave kohore, ndikimet e autorëve tjerë shqiptarë që dendur e përdorin (si: I. Kadare) e ndonjë arsye tjetër.

⁹ M. Çeliku përdor termin sifjali për fjalitë e periudhave.

¹⁰ Shembujt (të gjithë) i kemi vjelë nga romanet: “Hija”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë” dhe “Të jetosh në ishull”.

¹¹ Gramatika e gjuhës shqipe 2, AShSh, IGjL, Tiranë, 2002, f. 469.

¹² M. Çeliku, *Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)*, ShB, Ilar, Tiranë, 2008, f. 267.

¹³ Për më tepër shih: Bertoni Sulejmani “Funksioni sintaksor i lidhëzës **ndërsa** në të folmet shqipe në Maqedoni” (kumtesë e lexuar në punimet e Seminarit IX të Albanologjisë, Tetovë) dotuar në revistën “Albanologjia” v. 2, nr. 3-4, f. 25, Tetovë, 2015.

¹⁴ Sejfedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, f. 83, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.

¹⁵ P.sh. M. Isaku në romanin “Fatprerët”: *Ndërsa ai përpëltej në njërin nga qoshet e qelishë unë zura vend këmbëkryq mbi postajën e kurbanbajramit të cilën babai i mirë ma kishte sjellë tri ditë pas arrestit.*

2.1.5. Si e gjejmë këtë lidhëz te veprat e Mitrush Kutelit ?

Gjatë leximit të veprave: „Ago Jakupi dhe rrëfime të tjera”¹⁶ dhe „Tregime të moçme shqiptare” të Dhimitër Paskos (Mitrush Kutelit) më ra në sy një përdorim shumë i vogël i lidhëzës *ndërsa* - në të dy funksionet sintaksore të saj. Ja disa nga shembujt e vjelë nga veprat në fjalë:

*E motra e Gjergjit s’kish pasur kurrë çaste gëzimi. **Ndërsa** shoqet e saj gëzonin të ritë e tyre, kishin dashuruar, ishin martuar, kishin lindur fëmijë...* („TMSH”, f. 58)

*Kështu këndojnë zanat bjeshkëve, **ndërsa** në Jutbinë fillon dasma e dytë, më e madhe se e para.* („TMSH”, f. 97)

Ndërsa zotërit flinin qetas, në mes të natës dual gurrave zanat e bardha të malit e ia muar këngës. („TMSH”, f. 131)

Ndërsa zotërit e Jutbinës shkuan të lahen nëpër gurra e kronj e zjarri bubullonte nën bredhin e madh, Muji mori përpjetë ahishten, më këmbë, që të dalë majë bjeshkës. („TMSH”, f. 135)

*Dielli sapo kish rënë kulmeve e¹⁷ **ndërsa** ngjitej lart e më lart në kupën e qiellit, drit a etij zbriste poshtë e më poshtë: nga majat ulej prehërve, nga prahëret-rrëzave.* („TMSH”, f. 145)

Tek sillen rrotull që ta hedhin poshtë njëri-tjetrin, kreshnikët nisin e lëvdojnë vetveten, tregojnë trimërinë që kanë bërë. („TMSH”, f. 140)

Ndërsa po kuvëndonin kështu, herë shtruar e herë me zjarr për punë haraçi e për punë minjsh, që kishin përmjerë buzë detit dhe cihatenin “Deti është imi”! ... zunë të sosin mërgimtarë të tjerë... („Ago Jakupi dhe ...”, f. 42)

*Kur ariti përbri Çukës, që ku ngrihej anemban tym duhani, shikoi sa shikoi duke zhubrosur ballin dhe, së fundi, sikur u çel, u kthye përgjysmë e kuturisi t’u japë një tungjatjeta pak si të vëngërt: ngriti dorën në kapelën gështenjë për të përshëndetur evropjançe, pastaj ktheu mendjen, vuri pëllëmbën në zemër, preku dorezën e bastunit, e ngriti dorën shpëjt në ballë, allaturka, dhe tha me një zë që herë rritej, trashej, pastaj hollohej, ulej e këputej, ngrihej përsëri, **ndërsa** ai vetë qëndronte hijerëndë, i menduar...* („Ago Jakupi dhe ...”, f. 176)

Ndërsa lëmshi po i afrohej Çukës, Grendelli bubulloi: nga rrëza po s’qenë frëngë e frëngore! („Ago Jakupi dhe ...”, f. 194)

Numri më i madh i fjalive kohore në veprat e Kutelit, formohet me këto lidhëza e fjalë lidhëse: *kur, që kur, kur e kur, gjer, gjer sa, që nga, sa, sa po, si, ndërsa*. Përdorim më të dendur ka lidhëza *kur*. Ja edhe disa shembuj:

Si perëndonte dielli e binte të mungetit, ne lëshonim nga dora misritë e çekanët, sprisnim ne lumi e lanim duart, e robëtuaara e fytyrat e djegura nga vapa e ditës, edhe, pastaj, unjeshim e ja theshim darkës, së bashku, me se na jipte Zoti. („Ago Jakupi dhe ...”, f. 237).

Referencat

- [1]. Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa), ASHSH, IGJL, Tiranë, 2002.
- [2]. Çeliku, M., “Tekst ushtrimesh për sintaksën e shqipes standarde (pajisur me shënime teorike dhe me modele të zgjidhura)”, SHB “Ilar”, Tiranë, 2008.
- [3]. Mansaku, S., “Probleme të normës në përshtatjen e kallëzuesit me kryefjalën”, Gjuha jonë, Tiranë, 1985, 3, f. 46 – 54.
- [4]. Sulejmani, B., “Kongruenca e gjymtyrëve të fjalisë në shqipen standarde”, STUDIME ALBANOLOGJIKE (Gjuhë), 2012/1, viti XVII, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, konf. shkencore: “GJUHA SHQIPE NË 100 VJET SHTET SHQIPTAR”, f. 104 – 112.
- [5]. Sulejmani, B., “Rreth (a)kongruencës së kallëzuesit emëror me kryefjalën në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase”, SEMINARI IV NDËRKOMBËTAR I ALBANOLOGJISË, Tetovë-Shkup, 2010, f. 111 – 115.

¹⁶ Botuar nga Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, Reparti - Prishtinë, Rilindja, 1968.

¹⁷ Përdorimi i pjesëzës para lidhëzës e bën më të qartë funksionin kohor të lidhëzës *ndërsa*.